

The background of the cover is a photograph of a modern, multi-story white building with large windows. A red flag is flying from a pole in front of the building. In the foreground, there is a small tree with green leaves and a brick-paved area. The title text is overlaid on the lower half of the image.


Periodik mujor

Nr. 192

Maj 2025

Në
këtë
periodik
do të lexoni:

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive
e AMF-së pjesë e panelit ndërkombëtar në
Forumin e NAIC në SHBA për tregjet
në zhvillim dhe teknologjinë



VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri,
Janar-Prill 2025

Zhvillimet e tregut të fondeve të pensioneve private,
Janar-Mars 2025

5-6


BOTIME PROFESIONALE

7-8

INFORMACIONE NDËRKOMBËTARE

9-11

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, pjesë e panelit ndërkombëtar në Forumin e NAIC në SHBA për tregjet në zhvillim dhe teknologjinë



Znj. Kaçi theksoi se "Shqipëria dhe rregullatorët e Evropës Juglindore mund të luajnë një rol thelbësor për avancimin digjital të tregut të sigurimeve duke ndjekur standardet ndërkombëtare dhe modele rregullatore të përshtatura për realitetin e tregjeve në zhvillim, për të garantuar transparencë dhe për të forcuar mbrojtjen e konsumatorit."

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, zj. Mimoza Kaçi, mori pjesë në Forumin Ndërkombëtar të Sigurimeve 2025, organizuar nga Shoqata Kombëtare e Komisionerëve të Sigurimeve (NAIC), në Uashington D.C. Ky event global në fushën e sigurimeve, mbledhi drejtues të lartë të autoriteteve rregullatore, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe liderë të industrisë së sigurimeve për të diskutuar mbi zhvillimet më të fundit në tregjet globale të sigurimeve.

Në panelin me temë "Zhvillimi i Produkteve dhe Teknologjisë", znj. Kaçi solli përvojën e Shqipërisë, si pjesë e rajonit të vendeve të Evropës Juglindore, në transformimin e tregut të sigurimeve drejt dixhitalizimit dhe përfshirjes më të gjerë financiare. Ajo theksoi se: "Shqipëria dhe rregullatorët e Evropës Juglindore mund të luajnë një rol thelbësor për avancimin digjital të tregut të sigurimeve duke ndjekur standardet ndërkombëtare dhe modele rregullatore të përshtatura për realitetin e tregjeve në zhvillim, për të garantuar transparencë dhe për të forcuar mbrojtjen e konsumatorit."

Duke u ndalur tek strategjia kombëtare, znj. Kaçi nënvizoi se në Shqipëri, dixhitalizimi nuk përfaqëson vetëm një përmirësim teknologjik, por vepron si një katalizator strategjik në nivel kombëtar. Në këtë kontekst, edhe në sektorin e sigurimeve, ai luan një rol të rëndësishëm në nxitjen e gjithëpërfshirjes financiare dhe në forcimin e funksionit mbrojtës të këtij tregu.

Vijon ...

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, pjesë e panelit ndërkombëtar në Forumin e NAIC në SHBA për tregjet në zhvillim dhe teknologjinë



... Vijon

Paneli u drejtua nga z. Justin Zimmerman, Komisioner i Departamentit të Bankave dhe Sigurimeve të shtetit New Jersey. Pjesëmarrës të tjerë në panel ishin edhe zj. Ekhsuehi Iyahan, Sekretare e Përgjithshme e Forumit për Zhvillimin e Sigurimeve, dhe zj. Suzette Vogelsang, Eksperte e Lartë në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Ky përfaqësim në një forum prestigjioz ndërkombëtar nënvizon angazhimin dhe rolin proaktiv të Autoritetit në mbështetje të avancimeve teknologjike dhe digjitalizimit në tregje financiare.

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, Janar –Prill 2025

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për janar-prill 2025 kapën vlerën 7,666 milionë lekë, ose 8.14% më shumë se në janar – prill 2024. Gjatë periudhës janar-prill 2025, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 474,965 me një rritje prej 11.76% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 90.43% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 9.52% dhe risigurimi me 0.052%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 39.35% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 60.65% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-prill 2025, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 2,669 milionë lekë, ose 4.25% më pak se në janar-prill 2024.


Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për janar-prill 2025 kapën vlerën 1,992 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 0.84% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë janar-prillit 2025 arritën rreth 4,650 milionë lekë, ose 14.26% më shumë se në janar-prill 2024.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar-Prill 2025 (Në %)



Zhvillimet e tregut të fondeve të pensionit privat, Janar –Mars 2025



Vlera e aktiveve neto të fondeve të pensionit privat, Janar-Mars 2025
(Në %)

Gjatë periudhës janar-mars 2025, në tregun e fondeve të pensioneve private ushtruan aktivitetin e tyre shtatë fonde pensioni.

Analiza e të dhënave për tregun e fondeve të pensioneve private me pjesëmarrje (të hapur dhe të mbyllur) më 31.03.2025 tregon një total aktiveve neto prej 13,364.23 milionë lekë (85.21 milionë euro) me një rritje prej 493.42 milionë lekë, rreth 3.83% krahasuar me 31.12.2024.

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve private me pjesëmarrje (të hapur dhe të mbyllur), më 31.03.2025 rezultoi 46,377 anëtarë duke shënuar një rritje prej 3.23% krahasuar me 31.12.2024.

Numri i anëtarëve në fondet e pensioneve private

(Në numër)

FONDI I PENSIONIT PRIVAT	NR. I ANËTARËVE
SIGAL	15,925
CREDINS PENSION	19,260
RAIFFEISEN	4,732
ALBSIG	4,572
SMART PENSION	641
SIGAL PRO	582
TOTAL	45,712

IOSCO përfundon Takimin e saj të 50-të Vjetor me fokus të veçantë të mbrojtja e investitorëve me pakicë dhe zhvillimet teknologjike



IOSCO përfundoi Takimin e saj të 50-të Vjetor, organizuar nga Autoriteti i Tregjeve Financiare të Katarit (QFMA) në Doha. IOSCO mirëpriti afërsisht 500 pjesëmarrës gjatë tre ditëve, të pasuara nga konferenca e hapur e QFMA-së.

Takimi Vjetor i IOSCO-s bashkon të gjitha juridiksionet anëtare për të diskutuar çështjet dhe rreziqet më të rëndësishme në lidhje me tregjet financiare globale dhe mbështetjen e rregullatorëve në zbatimin e standardeve.

Jean-Paul Servais, Kryetar i Bordit të IOSCO-s dhe Kryetar i FSMA-së belge, theksoi: “Ne jemi thellësisht të përkushtuar për të mbështetur anëtarët tanë në përballimin e kompleksitetit të situatave si përmes lehtësimit të të nxënies nga kolegët, nxitjes së besimit dhe bashkëpunimit përmes MMoU-së sonë, ose hartimit të kornizave proporcionale të politikave në përputhje me objektivat tona të mbrojtjes së investitorëve, integritetit të tregut dhe stabilitetit financiar.”

Rodrigo Buenaventura, Sekretar i Përgjithshëm i IOSCO-s theksoi se “Mbrojtja e investitorëve me pakicë vazhdon të jetë një temë kryesore për të gjithë anëtarët e IOSCO-s dhe ne do të vazhdojmë të ofrojmë ndërtim kapacitësh për t'u përballur me sfidat në juridiksionet e tyre. Ndihej me fat që jam i rrethuar nga kaq shumë profesionistë që kontribuojnë dhe mbështesin me gatishmëri punën e IOSCO-s, në mënyrë që ne të arrijmë objektivat tona.”

vijon ...

Informacioni
gjendet në:
<https://www.iosco.org/news>

IOSCO përfundon Takimin e saj të 50-të Vjetor me fokus të veçantë te mbrojtja e investitorëve me pakicë dhe zhvillimet teknologjike

... Vijon

Krahas Takimit Vjetor u zhvilluan edhe tre seminare rregullatore për pjesëmarrësit, me tematika që lidheshin me qëndrueshmërinë për korporatat, zbatimin e kornizave të aseteve krypto dhe si të lundrojnë në financat private.

Autoritetet rregullatore që kishin nënshkruar së fundmi Memorandumin e Mirëkuptimit Shumëpalësh të Përmirësuar (EMMoU) të IOSCO-s përfshinin CMA Kenya, Komisionin e Letrave me Vlerë të Malajzisë dhe CNMV Spanjë. MMoU dhe EMMoU i IOSCO-s njihen si standardi kryesor për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndarjen e informacionit midis rregullatorëve në nivel global.

Bordi diskutoi zhvillimet e tregut dhe temat me interes të përbashkët si FinTech dhe Inteligjenca Artificiale. Ai miratoi publikimin e pesë Raporteve Përfundimtare, tre prej të cilave lidhen me punën e IOSCO-s në lidhje me mbrojtjen e investitorëve me pakicë online; Finfluencers, Praktikrat e Tregtimit Imitativ Online dhe Praktikrat e Angazhimit Dixhital. Dy Raportet e tjera Përfundimtare lidhen me Obligacionet e Qëndrueshme dhe Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit në investimet kolektive. Këto Raporte do të publikohen në ditët në vijim.

Informacioni
gjendet në:
<https://www.iosco.org>

KROACI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të ofruara nga Agjencia Kroate e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare (HANFA), 14 kompanitë e sigurimeve që operojnë në treg raportuan një vëllim prej 493 milionë euro për primet të paguara në tremujorin e parë të vitit 2025. Vëllimi i primeve të sigurimit të Jetës ishte 76.8 milionë euro dhe primet e sigurimit të Jo-Jetës arritën në 416.15 milionë euro. Duke filluar nga 1 janari 2023, Kroacia raporton primet e paguara, dhe jo primet e shkruara bruto.

Struktura e primit në sigurimet e Jo-Jetës dominohet nga sigurimi i përgjegjësisë për mjetet motorike, me 29.55% të totalit të primeve të mbledhura në treg), i ndjekur nga sigurimi i automjeteve tokësore, me 16.45% dhe sigurimi kundër zjarrit dhe fatkeqësive natyrore me 8.2%.

Shuma e dëmeve të paguara në tremujorin e parë të vitit 2025 arriti në 294.9 milionë euro. Nga kjo vlerë, 85.95 milionë euro lidheshin me sigurimin e Jetës, ndërsa 209 milionë euro lidheshin me sigurimin e Jo-Jetës. Në këtë vëllim të dëmeve të paguar në sigurimin e Jo-Jetës, shumat më të mëdha lidheshin me sigurimin e përgjegjësisë ndaj automjeteve motorike me 29.85%, sigurimin e automjeteve tokësore me 14.85%, dhe sigurimin kundër zjarrit dhe fatkeqësive natyrore me 5.23%.

MALI I ZI

www.xprimm.com

Sipas shifrave paraprake të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Malit të Zi (ISA), biznesi i siguruesve malazezë u rrit me 7.8% në tremujorin e parë të vitit 2025, krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2024, duke arritur vlerën e 37.16 milionë euro.

Primet e shkruara bruto nga sigurimet e Jo-Jetës arritën në total 30.55 milionë euro në periudhën janar-mars 2025, duke u rritur me 7% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në sigurimin e Jetës vëllimi i primeve arriti në 6.61 milionë euro, duke u rritur me 11.5% në krahasim me tremujorin e parë të vitit të kaluar.

Dëmet e paguara u rritën me 9.6% duke arritur në 14.37 milionë euro. Nga ky total, dëmet e paguara në sigurimin e Jetës arritën në 3.18 milionë euro krahasuar me 2.77 milionë euro me tremujorin e parë të vitit të kaluar. Ndërsa pagesat e dëmeve në sigurimin e Jo-Jetës u rritën me 8.22% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në 11.20 milionë euro. Ndikim kishte kryesisht rritja prej 15.7% e raportuar në segmentin MTPL dhe pothuajse +21.2% në sigurimin Kasko.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto për tregun e sigurimeve gjatë viti 2024 në Serbi arriti një vlerë totale prej 1.51 miliardë euro, duke shënuar një rritje prej 14.41% në krahasim me vitin 2023. Sigurimi I Jo-Jetës arriti një vlerë prej 1.23 miliardë euro duke u rritur me 16.08%, ndërsa sigurimi i Jetës arriti në 280 milionë euro, me një rritje prej 7.56% në krahasim me vitin 2023.

Gjithashtu rritje shënoi edhe vlera e dëmeve të paguara, me 11.19% në krahasim me vitin 2023. E shprehur në vlerë absolute, vlera e dëmeve të paguara gjatë vitit 2024 arriti në 739.79 milionë euro, nga të cilat 186.81 milionë euro, ishin dëme të paguara në sigurimet e Jetës dhe 552.97 milionë euro ishin dëme të paguar në sigurimin e Jo-Jetës.

Sigurimi i pronës pati një normë rritjeje dyshifrore të primeve të shkruara bruto prej 18.17% në krahasim me të vitin e kaluar, duke arritur në 296.6 milionë euro. Dëmet e paguara për kontratat në këtë klasë sigurimi u ulën me 4.3% krahasuar me vitin 2023.

Në sigurimet motorike, linja e sigurimit Kasko pati rritjen më mbresëlënëse të primeve me 18.8%, duke arritur në 169.16 milionë euro. Për klasën e sigurimit MTPL, primet u rritën me pothuajse 10% në krahasim me vitin e kaluar, duke arritur në 433.67 milionë euro. Paralelisht me këtë u rritën edhe pagesat e dëmeve: ndërsa primet e sigurimit motorik u rritën në përgjithësi me 12.27%, dëmet e paguara për kontratat e sigurimit motorik u rritën me 19.5%, kryesisht të nxitura nga segmenti MTPL.

VENDET E EUROPËS QENDRORE DHE LINDORE

www.xprimm.com

Siguruesit e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore realizuan një vëllim të primeve të shkruara bruto me vlerë 53.17 miliardë euro në vitin 2024, duke shënuar një rritje prej 7.69% në krahasim me vitin 2023. Pagesat e dëmeve gjithashtu u rritën ndjeshëm, me 14.93%, duke arritur në një total prej 27.91 miliardë eurosh, kryesisht të nxitura nga humbjet e siguruara pas ngjarjeve ekstreme të motit të verës dhe rritjes së kostove të riparimit. Pesë tregjet kryesore sipas vëllimit të primeve të shkruara bruto ishin:

Vendi	Vëllimi i primeve të shkruara bruto, 2024 (Në miliardë euro)	Ndryshimi ndaj vitit 2023 (Në %)	Pjesa ndaj totalit të primeve në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (Në %)
Polonia	20.05	10.51	37.71
Çekia	9.15	6.15	17.21
Rumania	4.71	10.94	8.86
Hungaria	4.13	4.91	7.78
Sllovenia	2.73	- 10.88	5.13

VENDET E EUROPËS QENDRORE DHE LINDORE

www.xprim.com

Vendet me rritjen më e fortë të vëllimit të primeve të shkruar bruto ishin Kosova me +14.63%, Shqipëria me +13.27%, Mali i Zi me +12.34%, Maqedonia e Veriut me 11.33% dhe Rumania me 10.94%.

Përsa i takon dëmeve të paguara, Çekia pati rritjen më të lartë midis të gjitha vendeve me rreth +25.35%, kryesisht për shkak të përmytjeve të shtatorit. Rumania gjithashtu pati një rritje të djeshme të dëmeve të paguara prej 23.47%, e nxitur kryesisht nga sektori i sigurimeve motorike, i cili jo vetëm që është mbizotërues në treg, por gjithashtu kishte rritje të kostove të dëmeve. Vetëm Estonia dhe Hungaria regjistruan një rënie të kërkesave, me Estoninë që pati rënie me -6.48% dhe Hungaria me -0.69%.

Sa i përket raporteve që këto vende kanë në tregun e përbashkët të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, Polonia dhe Rumania forcuan pjesët e tyre, ndërsa përqindja e Sllovenisë ra nga 6.20% në 5.13%. Shumica e tregjeve më të vogla mbetën të qëndrueshme në raportet e tyre me tregun në tërësi.

Me përjashtim të Sllovenisë, e cila ende po ndjen efektet e ndryshimeve dramatike në sektorin e saj të sigurimeve shëndetësore, i gjithë tregu i Evropës Qendrore dhe Lindore pati një dinamikë pozitive në sigurimet e Jo-Jetës. Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës arriti në 39.42 miliardë euro, duke u rritur me 8.4% në krahasim me vitin e kaluar. Megjithatë, dëmet e paguara në klasat e Jo-Jetës u rritën me 22%, duke arritur në 19.6 miliardë euro.

Rritja më e lartë e dëmeve të paguara ndodhi në sektorin e sigurimeve të pronës, i cili kishte një rritje mesatare prej 56.8% (të dhënat për Kosovën, Rumaninë dhe Slloveninë nuk janë të disponueshme). Ndërsa tregjet e vendeve të Ballkanit patën kryesisht rënie të pagesave të dëmeve, në Evropën Qendrore disa tregje përjetojnë një rritje të ndjeshme të dëmeve të paguara për humbjet e shkaktuara nga ngjarjet ekstreme të motit. Vëllimi i primeve të shkruara bruto u rrit me 12%, duke arritur një total prej 8.28 miliardë euro.

Klasat e sigurimit motorik regjistruan një dinamikë pozitive në drejtim të vëllimit të primeve të shkruara bruto, por edhe një rritje të konsiderueshme të dëmeve të paguara. Sigurimi Kasko u rrit me pothuajse 12%, në 8.85 miliardë euro, ndërsa dëmet u rritën me 15%, duke arritur në 4.36 miliardë euro. E njëjta tendencë u shfaq në linjën e sigurimit MTPL, vetëm me një ritëm disi më të ulët: Primet arritën në 12.17 miliardë euro (9.46% më shumë se viti 2023), ndërsa dëmet e paguara arritën në 10.46 miliardë euro, duke u rritur me 22.54% krahasuar me vitin 2023.



Për informacion
të mëtejshëm
kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al